



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 513/5 Prot.

Tiranë, më 16 /06/2016

VENDIM

Nr. 33, datë 16 / 6 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit Nr. 44/2015, "Kodit të Procedurave Administrative", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "BIRN Albania", ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr.513 Prot., datë 06.05.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*". Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 19.04.2016 ka kërkuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë t'i vihet në dispozicion dokumentet zyrtare/informacion në lidhje me projektin e hidrocentralit të Skavicës, si më poshtë:

1. Një kopje e studimit të kryer nga kompania "Sogreah" në vitin 2009;
2. Një kopje të kërkesës për koncesion të pakërkuar për hidrocentralin Katund i Ri;
3. Një kopje të procesverbalit të konsultimit me banorët e prekur nga hidrocentrali.

Me shkresën nr. 2811/1 Prot., datë 03.05.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke i sqaruar ndër të tjerat se: "*... - Në lidhje me kërkesën tuaj për t'ju vënë në dispozicion një kopje të studimit të kryer nga kompania "Sogreah" – viti 2009 dhe një kopje të kërkesës për koncesion të pakërkuar për HEC-in Katund i Ri, në bazë të pikës 1., nenit 1. "Objekti dhe qëllimi"; pikave 1.b dhe 1.c, të nenit 17 "Kufizime", të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe nenit 15 "Konfidencialiteti", të ligjit Nr.125/2013 "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", jemi të kufizuar të japim informacione apo dokumentacione. Kjo e drejtë mund t'ju jepet vetëm nëse titullari, që posedon sekretin tregtar apo të drejtën e autorit, jep pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës. – Në lidhje me kërkesën tuaj për t'ju vënë në dispozicion një kopje të procesverbalit të konsultimit me banorët e prekur nga HEC-i, na lejoni t'ju informojmë që aktualisht Grupi i Ekspertëve në bashkëpunim me konsulentin ndërkombëtar po zbaton procedurat standard për realizimin e procedurës përzgjedhëse, në zbatim të VKM Nr. 1068, datë 23.12.2015 "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për ndërtimin e hidrocentralit "Katund i Ri" mbi lumin "Drini i Zi". Informacioni që kërkohet nga ana tuaj mund t'ju jepet mbas përfundimit të procedurës përzgjedhëse dhe përcaktimit pas trajtimit me fituesin e konkurimit mbi parametrat e shtrirjes të koncesionit në tërësi."*

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik/ Ministria e Energjisë dhe Industrisë, ankuesi pretendon se: *“Argumentimi i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë është i pabazuar në ligj dhe mosdhënia e informacionit nuk mund të justifikohet me klauzolat e konfidencialitetit për arsye të mëposhtme:*

- 1. Studimi i “Sogreah” është pronë e taksapaguesve shqiptarë dhe si i tillë, nuk ka arsye të jetë konfidencial. Në dijeninë tonë, nuk ka procedurë të klasifikimit të këtij studimi si konfidencial dhe nuk ka arsye që ky studim të jetë konfidencial.*
- 2. Koncesioni për nga lloji është menaxhim i një aseti publik dhe e gjithë procedura e dhënies dhe administrimit të tij duhet të jetë transparente dhe publike. Në rast se propozimi i pakërkuar mbart sekrete industriale apo të patentave, mosdhënia e informacionit duhet të argumentohet duke cituar markat dhe patentat që e bëjnë këtë informacion konfidencial. Në të gjitha rastet, Ministria mund të fshijë ato pjesë të informacionit që klasifikohen konfidencial, duke shpjeguar në çdo rast bazën ligjore dhe administrative të klasifikimit të këtij informacioni konfidencial duke dhënë pjesën tjetër të dokumentit.*
- 3. Në lidhje me pikën e tretë, procesverbali i konsultimit publik mbi koncesionin për hidrocentralin Katund i Ri, për nga lloji, duhet të jetë një dokument publik për shkak se qëllimi i konsultimit është informimi dhe mbledhja e reagimit nga publiku”.*

Në këto kushte ankuesi Qendra “BIRN Albania” kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me Urdhër nr. 135 datë 18.05.2016, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Pranë këtij autoriteti u depozitua Urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 3467 Prot., datë 19.05.2016.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës “BIRN Albania” është depozituar dhe protokolluar me nr. 2811 Prot., datë 20.04.2016 pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe më pas i ka kaluar për trajtim Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit, e cila me shkresën nr. 2811/1 datë 03.05.2016 i ka kthyer një përgjigje kërkuarit.

Lidhur me ankesën e Qendrës “BIRN Albania”, u kontaktua me Koordinatorin e të Drejtës për Informim dhe personat përgjegjës. Nga ana e grupit të inspektimit u kërkua vlerësimi i përfaqësuesit të Autoritetit Publik/ Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nëse informacioni i kërkuar, përbën apo jo informacion publik, në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku citohet se *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik, dhe nëse po, pse nuk është vënë në dispozicion.*

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik/ Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sqaruan se:

“Në lidhje me pikën 1 të kërkesës, konkretisht “Një kopje e studimit të kryer nga kompania “Sogreah” në vitin 2009”, ky informacion nuk është informacion publik. Studimi i kryer është i kondicionuar nga sekretet tregtare dhe e drejta e autorit që përmban propozime me vlerë tregtare për zhvillimin e sektorëve të kësaj kompanie bazuar në kontratën tregtare të bërë nga Shoqëria Tregtare KESH sh.a dhe kompanis “Sogreah”. Duke qenë se ky projekt

është produkt i një Kontrate Tregtare midis Shoqërisë Tregtare KESH sh.a dhe kompanisë "Sogreah" theksojmë se një kopje e Draftit Final të atij studimi ruhet pranë arkivës së MEI-t në mënyrë konfidenciale, në bazë të urdhrat të Ministrit të METE Nr. 200, datë 11.3.2009 "Mbi ruajtjen e konfidencialitetin e studimit "Për përcaktimin e potencialit hidroenergjetik të lumenjve kryesore të Shqipërisë".

Në lidhje me pikën 2 të kërkesës, konkretisht "Një kopje të kërkesës për koncesion të pakërkuar për hidrocentralin "Katund i Ri", ky informacion nuk është informacion publik. Ky dokument mbahet nga MEI, por duke qenë se përmban sekret tregtar nuk mund të vihet në dispozicion deri në momentin e fillimit të procedurave të konkurrimit të përzgjedhjes ndërkombëtare nëpërmjet APP-së, referuar Ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Në lidhje me pikën 3 të kërkesës, konkretisht "Një kopje të procesverbalit të konsultimit me banorët e prekur nga hidrocentrali", sqaruan se ky proces zhvillohet pas përfundimit të procedurës përzgjedhëse, pra ky dokument nuk është prodhuar".

Në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seancë dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Me shkresën nr. 513/3 Prot., datë 02.06.2016, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 10.06.2016, ora 11:00 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Në seancën dëgjimore u paraqit ankuesi, Qendra "BIRN Albania" e përfaqësuar nga Z. Gjergj Erebara dhe Z. Besar Likmeta dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë përfaqësuar me autorizimin nr. 3860/1 prot., datë 10.06.2016 nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë Znj. Etleva Kondi dhe Specialistit pranë Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit Z. Vasil Pano.

Gjatë seancës dëgjimore palët paraqitën pretendimet e tyre si dhe depozituan parashtrimet në formë shkresore.

Ministria e Energjisë së Industrisë me shkresën nr. 3860/2 prot, datë 10.06.2016 sqaron se dokumentacioni që kërkon Qendra "BIRN Albania" nuk mund t'i vihet në dispozicion pasi: *Kërkesat për t'ju vënë në dispozicion një kopje të studimit të kryer nga kompania "Sogreah", në vitin 2009, për HEC-et "Katund i Ri" dhe "Skavica" mbi lumin Drin dhe një kopje të kërkesës për koncesion të pakërkuar për HEC-in Katund i Ri, kondicionohen nga pika 2.ç) e nenit 23 "Propozimet e pakërkua" të ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar, si dhe urdhri i Ministrit të METE Nr. 200, datë 11.03.2009, deri në momentin që të jetë përcaktuar oferta fituese apo procedurat e prokurimit të jenë përfunduar pa përcaktuar fitues. Aktualisht procesi i koncesionit të HEC-it "Katund i Ri" është në fazën e konkurimit. Kërkesa për një kopje të procesverbalit të konsultimit me banorët e prekur nga HEC-i dhe projekti do ti vihet në dispozicion kërkuarit pas përfundimit të procedurës përzgjedhëse dhe përcaktimit të parametrave të projektit të zbatimit. Për arsyet e mësipërme Ministria e Energjisë dhe Industrisë nuk mund të vendosë në dispozicion të palës kërkuar informacionin e kërkuar.*

Gjatë procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit konstatoi se Ministria e Energjisë dhe Industrisë disponon informacion në lidhje me shkronjën "a" dhe "b" të kërkesës,

konkretisht "Një kopje e studimit të kryer nga kompania "Sogreah" në vitin 2009 dhe një kopje të kërkesës për koncesion të pakërkuar për hidrocentralin "Katund i Ri" ndërsa në lidhje me shkronjën "c" ky institucion nuk disponon asnjë informacion apo dokumentacion.

Pas shqyrtimit të ankesës, parashtrimeve, seancës dëgjimore, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra "BIRN Albania" përbën informacion publik në kuder të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar, neni 1 citohet se: "Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike...".

Për sa më lart, dhënia e informacionit duhet të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar; Ligjin nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, duke respektuar në mënyrë specifike pronësinë intelektuale, sekretet tregtare ose të drejtat e tjera ekskluzive të parashikuara, që përmenden në propozim.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "BIRN Albania" ndaj Autoritetit Publik/Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "BIRN Albania", Nr. 513 Prot., datë 06.05.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 30. 6 .2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 16. 6 .2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI